

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6492
E shtunë, 18 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Nëntë drejtorë të klinikave të QKUK-së morën zyrtarisht detyrën | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA MBAJTUR FJALIMIN VJETOR NË KUVENDIN E KOSOVËS | FAQE 4-5

OPOZITA BOJKOTON FJALIMIN E PRESIDENTES NË KUVEND



Deputetët e subjekteve opozitare kanë bojkotuar fjalimin vjetor të presidentes Vjosa Osmani në Kuvend. Ata kanë bërë me dije se këtë e kanë bërë për shkak se shefja e kanë bërë për shkak se shefja e shtetit ka shkelur mandatin e saj si faktor uniteti. Në fjalimin e saj, presidentja Osmani ka folur për pandeminë, sundimin e ligjit, FSK-në, politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë. Ajo ka thënë se nuk do të lejojë që në procesin e Brukselit të preket sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës. Sipas saj, Kosova do të vazhdojë të luajë rol konstruktiv në këtë proces, ndonëse Serbia nuk e ka të njëjtën qasje

AKTUALE



RRETH 13 MILIONË NJERËZ TË PREKUR NGA STUHIA NË FILIPINE | F. 2

KURTI: PAGËN MINIMALE DO TË BËJMË 250 EURO | F. 7

CERTIFIKATAT E VAKSINIMIT MUND TA THELLOJNË IZOLIMIN E QYTETARËVE TË KOSOVËS | F. 3

EKONOMI



PARAQITET PROJEKTI PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E POLITIKAVE MIQËSORE PËR FAMILJEN NË SEKTORIN PRIVAT | F. 8

IFC-ja MBËSHKET KREDITË MIKROFINANCIARE PËR AGROBIZNESET | F. 8

SPORT



DERBI NË MES TË GOLDEN EAGLE YLLIT DHE PRIZRENIT 16 NË LIGËN UNIKE | F. 10

Kërkohe nga komunat zbatimi i masave kundër Covidit | FAQE 3



KOSOVA DHE KROACIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE TË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli do t'i ndalojë fluturimet nga Britania e Madhe

JERUSALEM, 17 DHJETOR- Franca nuk është shteti i vetëm që ndaloi udhëtimet nga Britania e Madhe. Të njëjtën ndalesë tani Izraeli do të vendosë ndaj udhëtimeve që vijnë nga Britania e Madhe, por edhe Danimarka. Izraeli vendosi këto dy shtete në "listën e kuqe" të koronavirusit në mesnatë mes 16 dhe 17 dhjetorit për shkak të shqetësimeve për përhapje të shpejtë të variantit të ri të virusit "Omicron". Qytetarëve dhe banorëve të përhershëm të Izraelit u

ndalohet të udhëtojnë në shtetet që ndodhen në "listë të kuqe" nga Izraeli përveç nëse marrin leje nga qeveria. Ndërkaq udhëtarët që kthehen nga ndonjë shtet nga "lista e kuqe", dërgohen në karantinë me të arritur në vend dhe duhet të qëndrojnë aty derisa testi për Covid-19 të rezultojë negativ. Franca, Spanja, Irlanda, Finlanda, Suedia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe pritet të shtohen në "listën e kuqe" të Izraelit nga e diela. Shumica e shteteve afrikane tashmë janë

në të. Izraeli mbylli kufijtë për pothuajse të gjithë shtetasit e huaj muajin e shkuar si përgjigje ndaj variantit "Omicron" disa javë pasi vendi u rihap për udhëtarët e vaksinuar. Më herët gjatë kësaj jave, ministri izraelit i Shëndetësisë, Nitzan Horowitz, u tha gazetarëve që Izraeli, megjithatë, nuk mund të mbyllet hermetikisht, por ka mundësi që përhapja e "Omicron"-it të vend të ndalohet.



Spasovski: Maqedonia e Veriut, e gatshme të përballet me çdo formë të terrorizmit



SHKUP, 17 DHJETOR - Maqedonia e Veriut po ndërmerr veprime serioze për ta luftuar terrorizmin ose për të parandaluar çdo aktivitet që mund ta rrezikojë gjendjen e sigurisë, ka deklaruar të premtën ministri i Punëve të Brendshme i Maqedonisë së Veriut, Oliver Spasovski. Spasovski u pyet nëse ka indikacione se gjendja e sigurisë në vend mund të prishet, qoftë lidhur me mosmarrjen e datës së nisjes së bisedimeve me Bashkimin Evropian, alarmeve

për "bomba të rreme", apo aspekte të tjera që ndërlidhen me rajonin në përgjithësi. Pas lëshimit në përdorim të një objekti policor në Shkup, donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Spasovski tha se "aktualisht nuk ka të dhëna për prishje të situatës së sigurisë në Maqedoninë e Veriut". "Kjo është një sfidë serioze. Për këtë arsye të gjitha autoritetet kompetente, Ministria e Brendshme, Agjencia e Sigurisë Kombëtare e Agjencia e Inteligjencës, po marrin masa

serioze për luftimin e terrorizmit ose parandalimin e çdo aktiviteti që mund ta rrezikojë situatën e sigurisë. Për momentin nuk ka të dhëna për ndonjë shkelje të situatës së sigurisë në vend. Të gjitha njësitë brenda Ministrisë së Brendshme dhe të gjitha agjencitë veprojnë në nivelin më të lartë. Në fakt, kohën e fundit raportet e rrejshme për akte terroriste treguan nivelin e gatishmërisë së policisë dhe agjencive maqedonase për t'u përballur me sfidë të tillë", ka thënë Spasovski.

Rreth 13 milionë njerëz të prekur nga stuhia në Filipine

SIARGAO, 17 DHJETOR - Një ishull i njohur turistik në Filipine, Siargao, është në mesin e zonave më të shkatërruara nga një tajfuni i fuqishëm që preku vendin. Tajfuni Rai goditi ishullin Siargao, ndërsa erërat arrinin shpejtësi deri në 195 kilometra në orë. Në provincën Surigao del Norte në perëndim të ishullit, prefekti i qytetit, Ernesto Matugas, i përshkroi pasojat e tajfunit si "të

rënda". "Gjithçka është dëmtuar, çatitë janë rrënuar dhe qasja në rrugë është e bllokuar nga rrëshqitja e dheut", ka thënë Matugas. Stuhia tropikale shkatërroi shumë shtëpi duke detyruar zhvendosjen e mijëra banorëve. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), vlerësohet se rreth 13 milionë njerëz u prekën nga stuhia. Deri më tani është konfirmuar vetëm një i

vdekur si pasojë e tajfunit. Ndonëse terminali kryesor i aeroportit në ishull është dëmtuar, pista tashmë është pastruar për të nisur operacionet e shpëtimt. Shteti i Filipineve shpesh goditet nga stuhitë e fuqishme, mesatarisht nga 20 sosh në vit. Tajfuni Goni, i cili preku vendin në nëntor të vitit 2020, ishte në mesin e më të fuqishmëve në Filipine vitet e fundit.



Festat e fundvitit, nën hijen e "Omicron"-it

NJU JORK, 17 DHJETOR - Derisa varianti i ri i koronavirusit, "Omicron", po përhapet shpejt në të dyja anët e Atlantikut, amerikanët dhe evropianët po hyjnë në sezonin e festave të fundvitit me ankth për herë të dytë. Shkencëtarët njëkohësisht po përpiqen të kuptojnë sa më

shpejt e sa më shumë rreth variantit të ri "Omicron". Presidenti amerikan Joe Biden më 16 dhjetor paralajmëroi se "Omicron"-i paraqet rrezik në ShBA duke krijuar valën e re të sëmundjes, ndonëse varianti "Delta" deri tash kontribuoi shumë në rritjen e numrit të të infektuarve dhe të vdekurve.

"I jemi afruar dimrit me shumë sëmundje dhe vdekje për të pavaksinuarit", tha Biden duke bërë thirrje që të vaksinuarit ta marrin edhe dozën e tretë, ndërsa të pavaksinuarit të vaksinohen. Ende ka shumë paqartësi lidhur me variantin e ri por, sipas zyrtarëve shëndetësorë,

dihet se "Omicron"-i përhapet shumë më shpejt sesa "Delta". Ministrat e shëndetësisë të shtatë shteteve më të industrializuara në botë e vlerësuan variantin "Omicron" si "kërcënimin më të madh ndaj shëndetit publik në botë", duke shtuar se "është më e rëndësishme se



kurrë më parë që shtetet të bashkëpunojnë nga afër".

Certifikatat e vaksinimit mund ta thellojnë izolimin e qytetarëve të Kosovës

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Qytetarët e Kosovës nga janari i vitit të ardhshëm mund të mos lejohen të udhëtojnë në vendet e Bashkimit Evropian, pasi blloku nuk i njeh ende certifikatat e vaksinimit kundër koronavirusit të lëshuara në Kosovë.

Për më tepër, BE-ja, nga 10 janari, synon t'i ndalojë të gjithë ata që nuk janë të vaksinuar me dozën e tretë të vaksinës. Aktualisht, për të hyrë në njërin nga vendet e bllokut mjafton testi negativ PCR i koronavirusit.

Vendimin përfundimtar për udhëtime nga jashtë, BE-ja pritet ta marrë në fund të dhjetorit.

Kosova, bashkë me Bosnjë e Hercegovinën, mbeten dy vendet e vetme të Ballkanit Perëndimor të cilave BE-ja nuk ua njeh certifikatat e vaksinimit, edhe përkundër faktit se në Kosovë jepen vetëm vaksinat "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca", të dyja të miratuara nga Agjencia Evropiane e Barnave dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë thotë se problemi me certifikatat është i natyrës teknike. "Jemi në fazën kur duhet të bëhet i lexueshëm kodi QR offline [pa qenë të lidhur në internet]. Aktualisht është i lexueshëm vetëm online. Çështja ka të bëjë me aspektin teknik", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" Dafina Gexha, zëvendësministre e Shëndetësisë. I ashtuquajtur kod QR, kur skanohet, ofron informacione për llojin e vaksinës së marrë, numrin e dozave dhe

vendin e vaksinimit.

Gexha thotë se janë duke punuar në mënyrë intensive që problemi të zgjidhet përpara 10 janarit, kur mund të hyjë në fuqi ndalimi i udhëtimit në BE pa tri doza të vaksinës. "Besoj se deri atëherë edhe kjo certifikatë do të kompletohet dhe qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa pengesa jashtë vendit", thotë Gexha.

Pa pengesa qytetarët e Kosovës nuk janë as tash.

Jehona Bajrami nga Prishtina ka ndarë me "Radion Evropa e Lirë" përvojën e saj nga pushimet verore në Francë dhe Itali.

Edhe pse të vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit, ajo dhe bashkëshorti i saj nuk kanë mundur të kenë qasje në shumë ambiente të mbyllura, të tilla si restorantet apo muzetë. "Në Bolonjë të Italisë deshëm të hyjmë në muze dhe nuk na lanë, nuk na e pranuan certifikatën. Atyre nuk u interesonte tutje kjo çështje", ka deklaruar Jehona. Sipas saj, opsioni i vetëm për të hyrë në vende të tilla ka qenë me test negativ të koronavirusit.

Mospranimi i certifikatave të vaksinimit e thellon edhe më shumë izolimin e kosovarëve të cilët nuk kanë as liberalizim vizash për të udhëtuar në BE, thotë Jehona. "Edhe ashtu jemi të marginalizuar si njerëz, sepse përpos hallit se sa inferior ndihesh në aeroport, gjithmonë ke njëfarë frike mos po të ndalin, të kthejnë, mos e ke vizën keq... plus kësaj t'ia shtojmë edhe



problemin [e mospranimi të certifikatës së vaksinimit]", ka thënë ajo.

Behxhet Shala, drejtues i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, thotë se është e padrejtë që qytetarët e Kosovës, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes për vaksinim dhe janë vaksinuar me vaksina të pranuar nga BE-ja, të izolojnë për çështje teknike. "Kjo është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut sepse, në njëfarë mënyre, përkundër asaj që i plotëson kushtet, e ke vaksinën, e ke vizën, nuk lejohet të lëvizësh. Është shkelje ekstreme e të

drejtave të njeriut", është shprehur Shala.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kufizimi i lëvizjes në bazë të dëshmisë së vaksinimit në tërësi është i padrejtë. Skënder Sylja, përfaqësues i OBSH-së në Bullgari, thotë se kur merren vendime të tilla, duhet pasur parasysh edhe shpërndarjen jo të barabartë të vaksinave nëpër botë. "OBSH-ja nuk e mbështet përdorimin e dëshmisë së vaksinimit si parakusht të vetëm për udhëtime ndërkombëtare, duke pasur parasysh përhapjen gjerësisht të pabarabartë të vaksinave midis

vendeve të pasura dhe me të ardhura më të pakta", ka thënë Sylja.

Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në fund të marsit.

Vaksinat e para i ka siguruar përmes donacioneve, ndërsa në maj ka nënshkruar kontratën e parë me kompanitë "Pfizer/BioNTech" për sigurimin e mbi një milion vaksinave. Deri më tash rreth 43 për qind e qytetarëve të Kosovës janë vaksinuar me nga dy doza. Nga 9 dhjetori ka nisur të administrohet edhe doza e tretë dhe përforcuese e vaksinës.

Kërkohet nga komunat t'i zbatojnë masat kundër Covidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë mbajtur të premtën një takim virtual me kryetarët e komunave me qëllim të koordinimit ndërinstucional për përballjen me pandeminë Covid-19.

Ministri Latifi i ka informuar kryetarët e komunave për gjendjen e përditësuar epidemiologjike dhe rrjedhën e procesit të vaksinimit.

Ministri Latifi dhe ministri Krasniqi kanë falënderuar kryetarët e komunave për bashkëpunimin duke pasur parasysh se përballja me pandeminë Covid-19 kërkon përkushtimin e tyre në kapacitete maksimale.

Ministri Latifi ka theksuar se në përputhje me rekomandimet e IKShPK-së dhe ekspertët shëndetësorë janë duke vlerësuar

në vazhdimësi situatën epidemiologjike dhe ka kërkuar mbështetjen dhe angazhimin e komunave për fuqizimin e zbatimit të masave. Ai ka thënë se krahas vaksinimit masat kundër Covidit mbeten mjetet e vetme për frenimin e pandemisë dhe evitimin e mbylljes totale.

Ministri Latifi ka thënë se kështu do të evitohet mbingarkesa spitalore dhe mbyllja e veprimtarive ekonomike dhe shkollave.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të premtën se nga 1 734 testime, 11 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes nga ky virus.

Të premtën janë shëruar edhe tetë qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 941.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 317.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 1 837 doza të vaksinës kundër



Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 651 845 doza të vaksinës. Deri më sot 775 898 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, bazuar në raportet nga klinikat Covid-19 dhe spitalet e përgjithshme, në trajtim janë 39 pacientë, 10 të konfirmuar me Covid-19 pozitivë

dhe 29 post-Covid.

Prej numrit të përgjithshëm të pacientëve, 12 pacientë janë me oksigjeno-terapi, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka pacientë.



PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, KA MBAJTUR FJALIMIN VJETOR NË KUVENDIN E KOSOVËS

Opozita bojkoton fjalimin e presidentes në Kuvend

Deputetët e subjekteve opozitare kanë bojkotuar fjalimin vjetor të presidentes Vjosa Osmani në Kuvend. Ata kanë bërë me dije se këtë e kanë bërë për shkak se shefja e shtetit ka shkelur mandatin e saj si faktor uniteti. Në fjalimin e saj, presidentja Osmani ka folur për pandeminë, sundimin e ligjit, FSK-në, politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë. Ajo ka thënë se nuk do të lejojë që në procesin e Brukselit të preket sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës. Sipas saj, Kosova do të vazhdojë të luajë rol konstruktiv në këtë proces, ndonëse Serbia nuk e ka të njëjtën qasje

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka garantuar qytetarët e Kosovës se nuk do të lejojë që dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë ta cenojë sovranitetin dhe integritetin e Kosovës. Në

adresimin vjetor para deputetëve, ajo ka thënë se ky proces nuk mund të ketë sukses në qoftë se nuk nxjerrim mësim nga gabimet e së kaluarës. Sipas saj, nga gabimet e së kaluarës duhet të mësojë edhe Kosova, por edhe BE-ja që e lehtësojnë këtë proces. "Dialogu nuk është dhe nuk do të lejojë asnjëherë që të

shndërrohet në dialog për statusin, për territorin, për funksionalitetin e brendshëm e për rendin kushtetues të vendit tonë. Idetë që kishin për synim ndarjet territoriale në vija etnike dhe aventurat e tjera të rrezikshme nuk do të përsëriten më në vendin tonë. Statusi i Kosovës është vendosur njëherë e përgjithmonë në përputhje me

vullnetin e popullit të saj", ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se idetë që kanë për qëllim segregimin e jo integrimin nuk janë as në të mirën e Kosovës e as të rajonit. "Në fakt, siç dëshmon historia, idetë e tilla krijojnë konflikte të reja e do të krijonin, po ashtu, jofunksionalitet në vend se të kontribuonin në paqe. Prandaj, me tërë atë që po ndodh së fundmi në Bosnjë e Hercegovinë, është e pakuptueshme se si ende ka zëra që shtyjnë përpara ide që në Kosovë thjesht do ta krijojnë krizën e njëjtë si në Bosnjë e Hercegovinë apo kriza të ngjashme me ato të krijuara nga Rusia në Ukrainë e në Moldavi.

Prandaj i ftoj të gjithë që të punojmë bashkërisht për t'i refuzuar idetë e shekullit të kaluar e të ecim përpara me ide të shekullit 21, ide që janë në frymën evropiane dhe që synojnë integrimin, harmoninë e bashkëjetesën. Shoqëritë dhe shtetet më të suksesshme në botë janë ato që kanë përqaftuar vlerat e diversitetit dhe integritetit të të gjithëve pa dallim. Kosova synon pikërisht këtë", është shprehur ajo, duke shtuar se në dialog duhet të ketë trajtim të barabartë të palëve.

Ajo ka bërë me dije se ky proces duhet të mbyllet vetëm njohje reciproke. "E fundit dhe më e rëndësishmja sa i përket dialogut: dialogu mund të ketë

Haradinaj ka dy kërkesa për Kurtin

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, të premten ka dalë me dy kërkesa për kryeministrin Albin Kurti. Në një konferencë për medie, ku ishte i shoqëruar edhe nga shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, lideri i kësaj partie i ka kërkuar Kurtit

që çdo ditë pune ta fillojë me një vizitë bashkë me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanollin, në Korporatën Energjetike të Kosovës, shkaku i situatës energjetike në vend. Kërkesa tjetër e Haradinajt drejtuar Kurtit ka qenë që kostoja e importit të rrymës të paguhet nga buxheti i këtij viti. "I bëj thirrje kryeministrit

Kurti për dy veprime: Të fillojë çdo ditë pune në KEK së bashku me ministren Rizvanolli gjatë gjithë dimrit dhe ta paguajë koston e importit nga buxheti i këtij viti e mos ta bartë në buxhetin e vitit tjetër, sepse krijon pengesa të mëdha në buxhetim të projekteve të tjera", ka deklaruar Haradinaj.



sukses nëse përmbillet duke pasur në qendër të vetmen zgjidhje e cila sjell paqe në rajon, e ajo është njohja reciproke, duke respektuar integritetin territorial, sovranitetin dhe rendin kushtetues të Republikës sonë, si dhe të drejtat dhe interesat e qytetarëve tanë. Prandaj, Serbia duhet të heqë dorë nga tendencat destabilizuese në veri, nga presioni ndaj qytetarëve serbë të Kosovës, si dhe nga përkrahja e strukturave ilegale, sikurse edhe të heqë dorë nga politikat agresive ndaj fqinjëve të saj”, ka thënë e para e vendit.

Në adresimin e saj, shefja e shtetit ka folur edhe për pandeminë, sundimin e ligjit, FSK-në dhe politikën e jashtme. “Si presidente dhe dhëheqëse e politikës së jashtme jam angazhuar që t’i mbroj dhe t’i shtyj përpara interesat e Kosovës, të bëj rienergizimin e aleancave me shtetet mike, si dhe ta trasoj rrugën për krijimin e aleancave të reja. Gjatë kësaj periudhe kam iniciuar praktikën e koordinimit të rregullt ndërinstucional me Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës në funksion të adresimit të sfidave dhe promovimit të qëllimeve të

përbashkëta në politikën e jashtme”, është shprehur ajo. Presidentja as këtë herë nuk ka harruar ta përmendë se Kosova mbetet e palëkundur në orientimin e saj euroatlantik.

Osmani është shprehur e bindur se vetëm me integrimin e plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe në NATO, projekti i Evropës së Bashkuar do të jetë më pranë realizimit të plotë. “Megjithatë, vonesa disavjeçare në procesin e liberalizimit të vizave po dëmton jo vetëm qytetarët tanë, por edhe kredibilitetin e BE-së. Prandaj po punojmë përshtur me shtetet anëtare, në veçanti me ato që kanë dyshime, që ky proces të përmbillet suksesshëm sa më shpejt”, është shprehur presidentja Osmani.

Opozita tregon arsyet e bojkotimit të fjalimit të presidentes

Fjalimi i presidentes Osmani nuk është dëgjuar nga deputetët e partive opozitare.

Ata e kanë bojkotuar adresimin e presidentes për disa arsye. Sipas tyre, e para e vendit ka marrë anë dhe gjatë mandatit të saj nuk ka përfaqësuar unitetin

Ish-kryeministri Hoti kritikon fjalimin e presidentes

Ish-kryeministri Avdullah Hoti i ka reaguar presidentes së vendit, Vjosa Osmani, për moratoriumin në marrëveshjen e Uashingtonit që kërkonte moslobimin për njohje të reja dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Osmani në adresimin vjetor para deputetëve ka thënë se me këtë moratorium ishte cenuar rendi kushtetues. “Si mund të cenohet rendi kushtetues i Kosovës nga Zyra Ovale e Shtëpisë së Bardhë, e cila e mbron shtetësinë e Kosovës më shumë se disa politikanë dhe bartës institucionesh në Prishtinë?! Vetëm politikanë të llojit të caktuar, me orientime

joperëndimore, mund të mendojnë dhe thonë gjëra të tilla. E vërteta është se vetë ekzistenca e shtetit të Kosovës rrezikohet kur cenohen raportet me mikun më të madh të shtetit të Kosovës - ShBA-në”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”. Sipas tij, një politikan i përgjegjshëm dhe properëndimor, që e sheh Kosovën shtet të pavarur dhe të integruar në BE dhe NATO dhe jo ndryshe, punon me maturi dhe i ruan miqësitë. “Zoti i bekoftë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe na ruajt nga politikanët e papërgjegjshëm!”, ka vlerësuar ai.

Osmani ka thënë se me këtë

memorandum janë dëmtuar interesat strategjike të Kosovës. “Duke aplikuar një politikë të jashtme tërësisht pasive të çakorduar në të kaluarën, e fatkeqësisht duke e pranuar moratoriumin që cenonte rendin tonë kushtetues dhe të drejtën për konsolidimin për subjektivitetin tonë ndërkombëtar, jo vetëm që u dëmtuan interesat tona strategjike, por edhe ishin dikur dritat e politikës sonë të jashtme. Këto drita jo vetëm që janë të ndezura, por po punohet përshtur që Kosovën ta kthejmë mbarë e të ecim përpara ashtu siç e meritojnë qytetarët e tanë”, ka thënë presidentja Osmani.

e popullit.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka vlerësuar se Osmani ka përdorur instrumentet e këtij

institucioni për qëllime të saj politike. “Duke i shërbyer agjendës politike të qeverisë dhe mazhorancës, presidentja Osmani ka dështuar të shërbejë si përfaqësuese e unitetit të popullit. Mandati i saj i deritanishëm është karakterizuar nga një numër shkeljesh dhe dështimesh. Në mes të tjerash, presidentja Osmani ka përdorur instrumentet e institucionit të Presidencës për t’i realizuar qëllimet e pushtetit, në mënyrë të kundërligjshme dhe kundërkushtetuese, siç është rasti me shkarkimin e ish-kryetares së KQZ-së, Valdete Daka. Një skandal ky që u pasqyrua edhe në raportin e BE-së për Kosovën”, ka shkruar Tahiri në profilin e vet në “Facebook”. Sipas tij, e para e vendit nuk ka arritur të lexojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamjet e mazhorancës që ka zgjedhur, raportet, temat dhe zhvillimet politike që janë interes i shtetit të Kosovës. “Presidentja Osmani ka manifestuar një paaftësi totale për ta ushtruar rolin

kushtetues, me theks të veçantë në agjendën e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Gjatë mandatit të deritanishëm, presidentja Osmani nuk është parë e interesuar dhe as e angazhuar për të siguruar njohje të reja për Republikën e Kosovës, përderisa ish-bashkëpartiajka e saj në krye të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka dështuar në mënyrë sistematike për t’iu kundërvënë mësymjes së Serbisë kundër shtetësisë sonë”, ka shkruar Tahiri.

Ndërsa AAK-ja ka vlerësuar se presidentja ka shkelur mandatin e saj si faktor uniteti. “Grupi parlamentar i AAK-së, në shenjë mospajtimi dhe revolte për faktin se presidentja e ka shkelur mandatin e vet si faktor uniteti, duke u bërë palë me kryeministrin, ne si grup parlamentar refuzojmë ta dëgjojmë fjalën e presidentes dhe e braktisim seancën”, është thënë në njoftimin e AAK-së. Gjithashtu, fjalimi i presidentes së vendit është braktisur edhe nga shumica e deputetëve të LDK-së.



KQZ-ja certifikon rezultatin zgjedhor për kryetar të Dragashit

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatin për kryetar të komunës së Dragashit. Zyrtarisht Bexhet Xheladini i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka fituar zgjedhjet.

Në mbledhjen e KQZ-së që është mbajtur të premten,

kryetari i saj, Kreshnik Radoniqi, ka bërë me dije se në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) nuk është bërë asnjë ankesë gjatë afatit 24-orësh. “Me nëntë vota për certifikohet rezultati për kryetar komune në Dragash, ku Bexhet Xheladini është zgjedhur kryetar i kësaj

komune. E kemi pranuar prej PZAP-it shkresën që nuk ka pasur ankesa lidhur komunën e Dragashit”, ka thënë kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi. Në këtë mbledhje është bërë edhe zëvendësimi i 15 asamblistëve, të cilët janë dorëhequr për arsye të ndryshme.



Kosova dhe Kroacia nënshkruajnë marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Me nderimet më të larta ushtarake, të premtën ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në vizitë zyrtare homologun e tij të Kroacisë, Mario Banozic, me ç'rast kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit bilateral të mbrojtjes.

Pas takimit kokë më kokë dhe në nivel të dy delegacioneve, të dy ministrat, pas aktit të nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale, u deklaruan para medieve të pranishme. Me këtë rast, ministri Mehaj ka thënë se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje hapen rrugë për bashkëpunim edhe më të ngushtë për shkollim dhe trajnim të personelit ushtarak, për zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta, për mundësi për bashkëpunim në operacione dhe misione ndërkombëtare, bashkëpunim më të theksuar në fushën e industrisë së mbrojtjes, gjithashtu edhe në fusha të tjera. "Marrëdhëniet në mes të Kosovës

dhe Kroacisë nuk janë vetëm diplomatike, për më tepër, ato janë miqësore pasi që të dy vendet i bashkon historia, sfidat e përbashkëta e që nënkupton interesa strategjike dhe vizione të përbashkëta, angazhim të përbashkët për çështje rajonale e globale, angazhim e dedikim për paqen e sigurinë e rajonit, e për këtë arsye jemi bashkë në rrugën e të ardhmes", ka thënë Mehaj. Ai ka theksuar se partneriteti me Republikën e Kroacisë është shumë i rëndësishëm pasi që Kroacia është vend anëtar i NATO-s prej më shumë se 11 vjet dhe se Republika e Kosovës e ka të njëjtin synim e aspiratë.

Në anën tjetër, ministri kroat i Mbrojtjes, Mario Banozic, ka thënë se me të dy vendet do të vazhdojnë ta thellojnë bashkëpunimin e mirë jo vetëm në fushën e mbrojtjes, por edhe në kontekstin politik dhe ekonomik. "Republika e Kroacisë e mbështet rrugëtimin euroatlantik të Kosovës dhe, sikurse deri më tani, edhe më tej do të ofrojmë ndihmë të fuqishme në këtë proces. Ne e mbështesim procesin e



transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura", ka thënë Banozic. Gjithashtu, ai ka thënë se dëshiron që sa më shpejt Republika e Kosovës të jetë anëtare me të

drejta të plota në organizatat dhe iniciativat rajonale, siç është edhe iniciativa e Kartës së Adriatikut A-5 pasi që, sipas tij, kjo është mënyra e duhur për forcimin e

dialogut rajonal dhe bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe që mund të jetë pjesë integrale e përgjigjes ndaj sfidave të sigurisë në rajon.

Lansohet instrumenti i investimeve kapitale për zhvillim të qëndrueshëm urban



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER)- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim dhe partneritet të ngushtë me Programin për Vendbanime Njerëzore i Kombeve të Bashkuara (UN-Habitat Kosova) dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) mbajtën ceremoninë për lansimin dhe hapjen e thirrjes për propozime të Instrumentit për Investime Kapitale (CIF).

Ky instrument është zhvilluar duke u bazuar në përvojën e pasur të MAPL-së, UN - Habitatit dhe MMPHI-së në fushën e zhvillimit të projekteve kapitale bashkë me komunat. Zhvillimi i projekteve do të jetë nga poshtë-lart që në vete përmban gjithëpërfshirje, pjesëmarrje

dhe transparencë, duke ua ofruar mundësinë komunave për ndërtimin, rregullimin fizik të objekteve, infrastrukturës, shërbimeve të qëndrueshme të cilat vijnë nga planet hapësinore dhe të cilat janë të dobishme për mjedisin.

Thirrja është hapur për të 38 komunat e Republikës së Kosovës me fokus në parimet kyçe, si: Kohezioni social - së bashku formësojmë bashkekzistencën në mes të komuniteteve; Bashkëpunimi ndërkomunal - punojmë përtej kufijve për agjenda të përbashkëta; Ripërtëritje e qëndrueshme urbane - dizajnojmë lagje të ndjeshme ndaj klimës dhe të gjallërishe. Ky do të jetë program i përbashkët katërvjeçar 2022-2025 dhe do të ketë thirrje çdo vit.

Komandanti i FSK-së priti në takim komandantin e kontingjentit turk në Kosovë

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER)- Komandanti i FSK-së, gjeneraljtënant Bashkim Jashari, ka pritur të premtën në takim komandantin e kontingjentit turk në Republikën e Kosovës, kolonel Fatih Cansir. Me këtë rast, gjeneral Jashari e falënderoi kolonelin Cansir

për kontributin e kontingjentit turk në shërbim të sigurisë së vendit si dhe mbështetjen për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së.

Nga ana e tij, kolonel Cansir uroi gjeneral Jasharin për marrjen e detyrës së re, në krye të FSK-së, duke shprehur

gatishmërinë e plotë për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit. Në fund, të dy u pajtuan që shtimi i bashkëpunimit në mes forcave të të dy vendeve partnere është interes i përbashkët, si dhe në funksion të sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë.



Kurti thotë se pagën minimale do ta bëjmë 250 euro

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të premten në takim kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykolli, me të cilin ka biseduar për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të punëtorëve si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Kurti ka thënë se qeveria do të punojë për hartimin e ligjit të ri për pagat, i cili do të ofrojë një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme të sistemit të pagave në sektorin publik

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Atdhe Hykolli, janë takuar të premten në qeveri. Ata kanë diskutuar mbi bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet qeverisë dhe BSPK-së për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të punëtorëve si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Kryeministri Kurti ka thënë se ai mbetet i përkushtuar për fuqizimin e të drejtave të punëtorëve dhe respektimin e plotë të Ligjit të Punës

nëpërmjet rritjes së kapaciteteve inspektuese. Ai, po ashtu, tha se qeveria është partnerja kryesore sociale për mbrojtjen, realizimin dhe avancimin e të drejtave dhe mirëqenies së punëtorëve. Në takim u bisedua edhe për Ligjin e Pagave dhe pagën minimale.

Sa i përket Ligjit të Pagave, kryeministri Kurti ka thënë se qëllimi primar i tij do të jetë që të krijojë transparencë dhe barazi në sektorin publik, për dallim nga ai paraprak, që është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese që, sipas tij, përveç se ishte ligj i dobët, ishte edhe i dëmshëm duke qenë se ishte diskriminues dhe krijonte

parabazë. “Ne tani po punojmë intensivisht për hartimin e ligjit të ri që do të ofrojë një zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme të sistemit të pagave në sektorin publik. Duke e trajtuar me thellësinë dhe kujdesin e nevojshëm, e duke mos u nxituar, ne po tregojmë

përgjegjësinë tonë për trajtimin e këtij ligji kaq të rëndësishëm që ka munguar tash e 22 vjet”, u shpreh kryeministri Kurti. Në lidhje me pagën minimale ai ka thënë se gjatë mandatit të tij, sikurse është zotuar para qytetarëve dhe miratuar në programin qeverisës, ajo do të

ngritet në 250 euro.

Në këtë takim u bisedua edhe për çështje të tjera që për synim kanë ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për formë kanë bashkëpunimin e sinqertë dhe korrekt ndërmjet qeverisë dhe BSPK-së.

Nis përgatitja e planit të veprimit për shëndetin e kafshëve



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER)- Në ambientet e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) është mbajtur takimi trepalësh projekti BE-AUV-OVK, ku është diskutuar në lidhje me projektin e financuar nga BE-ja “Mbështetje për krijimin e programeve të mbikëqyrjes dhe kontrollit të sëmundjeve dhe përafrimit me kapitullin 12 të acquis (NEAR/PRN/2020/EA-RP/0009)”. Eksperti kyç për komponentin e shëndetit të kafshëve, Francesco Bonicelli, ka thënë se projekti ka dy qëllime: t’i forcojë mekanizmat për mbikëqyrjen, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve në Kosovë drejt

standardeve të BE-së; dhe ta përgatisë “udhërrëfyesin” për përafrimin e legjislacionit kombëtar me kapitullin 12 të acquis të BE-së për sigurinë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. Ai ka thënë se aktiviteti i parë në këtë komponent të planit është identifikimi i nevojave për trajnim për VPTP-të. Sipas tij, vlerësimi i nevojave për trajnime të propozuar do të kryhet përmes pyetësorit të hartuar posaçërisht, i cili do të plotësohet nga VPTP-të. Kryetari i Odës së Veterinerëve e Kosovës, Xhevdet Krasniqi, në emër të OVK mirëpriti këtë iniciativë dhe premtoi që do

kontribuojë me këshilla rreth përmbajtjes së pyetësorit dhe ta mbështesë projektin përmes përcjelljes me VPTP-të për plotësimin e pyetësorit dhe zbatimin e trajnimeve gjatë periudhës 2022-2024. Ai kërkoi që në të ardhmen të ketë numër më të madh të kafshëve për hulumtime diagnostike. Ai, gjithashtu, ka premtuar se Oda e Veterinerëve e Kosovës do të marrë pjesë aktive në grupin punues bashkërisht me stafin e AUV-së dhe përfaqësuesit e projektit të BE-së gjatë përgatitjes së planit të veprimit për shëndetin e kafshëve për periudhën 2022-2027.

Nëntë drejtorë të klinikave të QKUK-së morën zyrtarisht detyrën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Në praninë e kryesueses së Bordit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Agreta Gecaj-Gashi dhe drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, nëntë drejtorë të klinikave të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës morën të premtën zyrtarisht detyrën. Menaxhmenti i ShSKUK-së u ka ular suksese drejtorëve, derisa

ka kërkuar nga ta që të jenë në nivel të detyrës, t’i marrin përgjegjësitë dhe të angazhohen maksimalisht për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët. Menaxhmenti i ShSKUK-së u shpreh i bindur se drejtorët e klinikave, duke marrë parasysh edhe punën dhe përvojën e tyre, do ta përmbushin me sukses misionin e tyre. Drejtorët e zgjedhur janë: Naser Sylja, drejtor i Klinikës Emergjente; Shemsi Veseli,

drejtor i Klinikës së Biokimisë; Violeta Zatriqi, drejtoreshë e Kirurgjisë Plastike; Gazmend Spahija, drejtor i Klinikës së Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv Qendror; Merita Sadiku-Emini, drejtoreshë e Klinikës së Endokrinologjisë; Besnik Elshani, drejtor i Klinikës së Neurokirurgjisë; Musa Hoxha, drejtor i Klinikës së Pulmologjisë; Fitore Komoni, drejtoreshë e Klinikës së Gastroentologjisë; dhe Arben Vishaj, drejtor i Klinikës Infektive.



Paraqitet projekti për njohjen dhe zbatimin e politikave miqësore për familjen në sektorin privat

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) në kuadër të projektit “Më shumë zgjedhje: Politikat e përgjegjshme gjinore për familjen për sektorin privat”, në bashkëpunim me Fondin për Popullsi të Kombeve të Bashkuara (UNFPA), ka mbajtur një tryezë me temën “Njohja dhe zbatimi i politikave miqësore për familjen në sektorin privat në Kosovë”.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në fjalën e tij hyrëse, ndau me të pranishmit objektivat që synohen të arrihen përmes projektit të përbashkët me UNFPA-n dhe përcolli mesazhin te kompanitë e shumta pjesëmarrëse se qëndrueshmëria e kompanive lidhet ngushtë me familje të shëndosha dhe mirëqenien e shoqërisë.

Ndërsa udhëheqësja e Zyrës së UNFPA-s në Kosovë, Visare Mujko-Nimani, ka falënderuar bizneset për pjesëmarrjen në numër aq të madh në këtë ngjarje, duke theksuar se vendet e punës miqësore kontribuojnë jo vetëm në mirëqenien e punëtorëve dhe familjeve të tyre dhe shoqërisë, por edhe në



prosperimin e bizneseve dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Në këtë tryezë u paraqit projekti “Më shumë zgjedhje përmes politikave miqësore për familjen” nga Dea Pallaska O’Shaughnessy, bashkëpunëtoare e programit në UNFPA dhe koncepti “Vende pune miqësore me familjen” nga Era Jashari, këshilltare për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Zhvillim të Shërbimeve në Odën Ekonomike të Kosovës.

Pas fjalëve hyrëse dhe paraqitjeve, ngjarja vazhdoi me

diskutimin në panel që trajtoi njohjen, rëndësinë dhe zbatimin e politikave miqësore për familjen nga kompanitë e sektorit privat dhe pozicionimin e tyre si ‘vende pune miqësore me familjen’.

Pjesë e panelit ishin përfaqësues të disa kompanive kampione të cilat janë në procesin e pilotimit të politikave të vendeve të punës miqësore me familjen si dhe Gëzime Hasani nga Rrjeti CSR Kosova. Kompanitë kampione të cilat janë në procesin e pilotimit të modeleve të

vendeve të punës miqësore me familjen janë: Gjirafa, Kivo, Cactus, Raiffeisen Bank, Kosbit, Super Viva dhe Art House.

Ajo që u dëshmuar është se sektori privat ka shumë interesim për implementimin e politikave miqësore për familjen sepse duke krijuar kushte për familje të shëndetshme krijon kushte për vende stabile.

Sektori privat ka kuptuar këtë ndërlidhje si shumë të rëndësishme sepse të punësuarit janë shtyllë e

rëndësishme për funksionimin e kompanisë dhe mirëqenia e tyre është parakusht për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e kompanive. Objektiva kryesore e projektit të përbashkët OEK - UNFPA është të krijohet një kuptim i përgjithshëm i politikave miqësore për familjen dhe të angazhohen kompanitë e sektorit privat si pionieret kryesore të ndryshimit në funksion të avokimit, promovimit dhe implementimit të këtyre politikave.

IFC-ja mbështet kreditë mikrofinanciare për agrobiznesin

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Mikrondërmarrjet, agrobizneset dhe fermerët e vegjël, duke përfshirë kompanitë në pronësi të grave në Kosovë, do të kenë qasje të përmirësuar në financim me një investim të IFC-së në tri institucionet mikrofinanciare (IMF). Kjo do të ndihmojë në ngritjen e konkurrueshmërisë në sektorin agrofinciar, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e jetesës dhe ngritjen e sigurisë ushqimore në vend.

IFC, së bashku me Dritaren e Sektorit Privat të Programit Global të Bujqësisë dhe Ushqimit (GAFSP), ka aprovuar kredi prej 8 milionë eurosh për KEP Trustin (KEP), Kreditimin Rural të Kosovës (KRK) dhe Agjencinë për Financim në Kosovë (AFK).

Duke adresuar mungesën për financim me të cilin ballafaqohen agrobizneset e vogla dhe fermerët, fondet e kredisë do të përdoren për huadhënien e mëtejme të ndërmarrësve individualë dhe mikrobizneseve në Kosovë prej të cilave të paktën 50 për qind të dedikuara për agrobizneset. Mbi 60 për qind e qytetarëve të



Kosovës jetojnë në zonat rurale dhe janë të varur nga bujqësia. Bujqësia është një nga kontribuueset kryesore në ekonominë e Kosovës, duke zënë rreth 8 për qind të bruto produktit vendor (BPV), 18 për qind të eksporteve dhe rreth 30 për qind të punësimit. Megjithatë, sektori është i nënshërbyer nga bankat, duke

limituar rritjen e bizneseve të vogla dhe fermerëve. “Kredia e IFC-së do t’u ofrohet mikrondërmarrjeve vendore, të vogla dhe të mesme, veçanërisht duke pasur qëllim financimin e investimeve të cilat do ta ngrehin konkurrueshmërinë e MNVM-ve në tregjet vendore dhe ato rajonale”, ka thënë Lulzim Sadrija, kryeshef ekzekutiv i

KRK-së. Ndërkaq Shpend Nura, kryeshef ekzekutiv i KEP-it, ka thënë se kredia e IFC-së dhe GAFSP-së do ta rrisë ndjeshëm kapacitetin kreditues për grupin e tyre specifik të klientëve në Kosovë. “Zhvillimi i bujqësisë është i një rëndësie të madhe, prandaj një pjesë e madhe e portofolit tonë u dedikohet mikrondërmarrjeve

dhe atyre të vogla në agrobiznes dhe bujqësi”, ka thënë ai.

Financimi nga IFC-ja dhe GAFSP-së përfshin kreditë afatgjata - 4 milionë euro për KEP-in, 3 milionë euro për KRK-në dhe 1 milion euro për AFK-në. Meqenëse IMF-të në Kosovë kanë qasje të kufizuara në fonde, mbështetja e IFC-së do ta frymëzojë besimin në mesin e kredihënësve të tjerë, në veçanti të bankave private, duke i shtyrë ato që të ofrojnë financim për industrinë mikrofinanciare. “Me mbështetjen e vazhdueshme financiare nga IFC-ja, AFK-ja ka arritur te një numër më i madh i fermerëve të vegjël pa mbështetje financiare në Kosovë, duke u ofruar qasje të qëndrueshme në mikro-kredi”, ka pohuar Vahdet Anadolli, kryeshef ekzekutiv i AFK-së.

Ai ka thënë se në mes të pandemisë me Covid-19, një nga prioritetet strategjike të IFC-së në Kosovë është që të ndihmojë në përmirësimin e qasjes te kreditë për MNVM-të, veçanërisht segmentet më të ndjeshme dhe të nënshërbyera, duke përfshirë kompanitë në pronësi të grave dhe agrobizneset.

Walt Disney, njeriu që na bëri të fluturojmë në botën e fantazisë



Ishte vetëm 22 vjeç kur në vitin 1923 u nis drejt Kalifornisë, me një biletë vajtje-ardhje dhe 40 dollarë në xhep. Ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, ishte shndërruar në bosin e industrisë më të lulëzuar të filmit në Hollivud. Ai vdiq në Los Anxhelos më 15 dhjetor 1966. Emri i tij është kthyer tashmë në një legjendë në historinë e kinemasë. Fitues i 26 çmimeve Oskar, dhe i shumë çmimeve të ndryshme ndërkombëtare, Diznej ka emocionuar dhe argëtuar shumë breza spektatorësh, duke arritur një sukses kaq të madh sa që shpesh konsiderohet si shpikësi i filmave vizatimorë. Në fakt kjo teknikë ekzistonte prej rreth 20 vitesh, por ishte imagjinata dhe vendosmëria e Diznej ajo që e ngriti në majë. Uollter Elias Diznej Xhunjor, i katërti nga pesë fëmijë, lindi në Çikago në vitin 1901 në një familje me origjinë modeste. Vitet e fëmijërisë ishin të vështira. I ati, një burrë shumë autoritar, e detyroi të punonte me orë të tëra në aktivitetet familjare, dhe nuk i kurseu ndëshkimet trupore ndaj tij. I riu e ngushëllonte veten me vizatimin, një nga pasionet e tij më të mëdha; me lojërat që luante bashkë me vëllain e tij pak më të madh Roin; me përrallat e dashura që i lexonte e ëma në mbrëmje; dhe me magjinë e kinemasë të Çarlie Çaplin. Menjëherë pas studimeve mbi artin midis Kansas Sitit dhe

Çikago, Uollti nisi t'i përkushtohej animacionit. Hapat e parë i hodhi në bashkëpunim me mikun e tij Ub Ajuerks. Të dy realizuan disa filma me metrazh të shkurtër. Por kohët ishin të zymta dhe plot vështirësi financiare. Në këto kushte ai u transferua në Los Anxhelos, duke shpresuar për një fat më të mirë në karrierë. Në fakt i riu Uollt nisi të ecte shumë shpejt, dhe në vitin 1923 themeloi kompaninë e tij të prodhimit "Disney Brothers Cartoon Studio", së bashku me vëllain e tij. Atje nisi të punojë krah për krah me një vajzë elegante dhe bukuroshe të quajtur Lilian Baunds: Ai vizatonte, ajo i mbushte me bojë. Por mungesa e talentit artistik, dhe një farë interesi i Uollt ndaj saj, e nxitën atë të ndërronte punë dhe të bëhej sekretarja personale e Diznej, dhe menjëherë më pas bashkëshortja e tij. Ata martuan në vitin 1925, dhe në 1933 patën vajzën e tyre të parë dhe të vetme biologjike, Diana Maria. Për të festuar lindjen e saj, Uollt njoftoi se në ditën e parë të premierës së çdo filmi të kompanisë së tij, shfaqja do të ishte falas për të gjithë jetimët. Disa vite më vonë ata adoptuan vajzën e tyre të dytë, Sharon Mae. Lili dhe Uollt do të jetonin bashkë deri në vdekjen e tij në vitin 1966. Në vitin 1927, lindi seriali i lepurit me fat Osvald, një personazh që Ajuerks e shndërroi shpejt në një mi duke ripunuar disa skica. Lilian e

pagëzoi me emrin Miki Maus, dhe ishte vetë Diznej, ai që i dha atij personalitet dhe zë. Ishte pikërisht ky personazh emblema e perandorisë Diznej, që bëri debutimin e tij me zë. Filmi i shkurtër i vitit 1928 u quajt "Avullorja Uilli" dhe u prit me shumë entuziazëm. Një pionier i vërtetë i teknikave të animacionit, Diznej ishte gati të rrezikonte falimentimin në mënyrë që t'i ngrinte prodhimet e tij në një formë të re arti. Pas futjes së zërit në këto filma, ai eksperimentoi me përdorimin e muzikës dhe ngjyrës, për të përmirësuar atmosferën e filmave të tij të shkurtër, të cilët arritën kulmin e tyre më të suksesshëm në vitin 1933 me "Tre derrkucat e vegjw". Për Diznej, animacioni ishte mjeti me të cilin tregoheshin histori, të cilat zgjonin një gamë të gjerë emocionesh. Ishte ky vizion që solli në vitin 1937 realizimin e filmit të parë artistik në historinë e animacionit "Borëbardha dhe Shtatë Xhuxhat". Ky film jo vetëm që arkëtoi shumë fitime dhendikoi në zgjerimin e kompanisë (e cila u rrit në mbi 1000 punonjës), por i hapi rrugën prodhimit të shumë klasikëve të tjerë, si "Fantazia" dhe "Pinoku" (që të dyja në vitin 1940), "Dumbo" (1941), Bambi (1942), "Hirushja" (1950), "Liza në Botën e Çudirave" (1951), dhe "Piter Pan" (1953). Megjithatë, në shumë prej filmave të tij, ndikim fantastik i Diznej merr një dimension më të thellë dhe më të errët. Sipas

biografisë së Mark Eliot "Uollt Diznej, princi i errët i Hollivudit, në çdo film artistik pasqyrore aspekte të ndryshme të temës së gjerë të cilën ai e kishte më shumë për zemër: shenjtërinë e familjes. Nuk është rastësi që tema më e prekur është ajo e braktisjes dhe kërkimit të prindërve të vërtetë nga protagonistët. Kur ishte në moshë të re, pasie pati të pamundur të merrte pjesë në Luftën e Parë Botërore sepse ishte i mitur, Uollti zbuloi mos-ekzistencën e certifikatës së tij të lindjes. Ai nisi të dyshojë se mos ishte birësuar, aq sa me këtë arsye nisi të justifikonte ndëshkimet që kishte pësuar kur ishte fëmijë. Kjo trashëgimi e nxiti atë ta shihte kompaninë e tij si një familje të madhe, një prirje që i bëri goxha të forta grindjet me punonjësit. Karakteri i tij despotik, i krijoi jo pak probleme në marrëdhëniet e tij me animatorët. Shumë shpejt raportet u bënë shumë konfliktuale, sidomos kur Uollt nuk donte të njihje kontributin e tyre si krijues. Për më tepër pagat e ulëta, shkarkimet e pajustificuara nga puna dhe refuzimi i mbledhjes së punonjësve në një sindikatë, i shtuan konfliktet. Në majin e vitit 1941 punonjësit hynë në një grevë të plotë. Ata mbanin në duart parulla në hyrje të kinemasë, ndërsa iu bashkuan qindra qytetarë që mbanin pankarta me slogane dhe karikatura të personazheve të famshëm të Diznej. Përplasja

zgjati dy muaj, derisa autoritetet federale njohën të drejtën e grevistëve për rritjen e pagës, për pushime të paguara, për rikthimin në punë të të shkarkuarve si dhe për ekzistencën e sindikatës. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, studiot e Diznej u angazhuan gjithashtu për të prodhuar filma propagandistikë për llogari të qeverisë amerikane. Midis dhjetëra filmave, më i njohuri dhe fitues i Oskarit për filmin më të mirë të shkurtër të animuar është "Fytyra e Fyherit", me protagonist Donald Dauk që përjeton makthin e të jetuarit nën regjimin nazist. Por angazhimi politik dhe ideologjik i Diznej nuk përfundoi me përfundimin e konfliktit. Tensionet e Luftës së Ftohtë dhe fillimi i "gjuetisë së shtrigave" ndaj komunistëve të dyshuar që goditi edhe Hollivudin në vitet 1950, panë vendosjen e Uollt Diznej në krye të luftës kundër "trezikut komunist". Nën këtë arsye, ai nisi të largojë nga puna disa punonjës që kishin hyrë në grevë vite më parë. Ai dëshmoi në Komitetin kundër Aktiviteteve Anti-amerikane (HUAC), dhe denoncoi infiltrimin e komunistëve në kompaninë e tij. Në vitet e Makaritzmit, ai ishte një informator i FBI-së, që drejtohej nga miku i tij Xh. Edgar Huver. Diznej la gjurmë të pashlyeshme edhe në kinema me filmin "Meri Popins", i publikuar në vitin 1964, 2 vjet para vdekjes së tij. / Focus – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Derbi në mes të Golden Eagle Yllit dhe Prizrenit 16 në Ligën Unike



PRISHTINË, 17 DHJETOR - Xhironja e shtatë e Ligës Unike do të sjellë përballje interesante, që është e fundit për stinorin vjeshtor. Në këtë xhiro do të zhvillohen dy përballje në mes të skuadrave të Kosovës dhe dy mes atyre të Shqipërisë. Takimi i parë është ndërmjet Pejës dhe Rahovecit. Pejanët kanë katër fitore dhe dy humbje, kurse rahovecasit dy fitore dhe katër humbje. "Verdhezinjtë" kanë ambicie të mëdha në këtë edicion, kurse "vreshtarët" kanë pasur ngritje të formës dhe synojnë pozitë sa më të mirë për garat e rregullta. Sot (e shtunë) Teuta e Durrësit e pret Vllazninë e Shkodrës. Durrsakët

kanë tri fitore dhe tri humbje, ndërsa shkodranët një fitore e pesë humbje. Derbi do të zhvillohet të dielën në mes të Golden Eagle Yllit dhe Prizrenit 16. Ylli ka pesë fitore dhe një humbje, ndërsa prizrenasit katër fitore e dy humbje, andaj pritet një sfidë shumë interesante mes dy skuadrave që kanë ambicie të mëdha dhe synojnë të shpallen kampione vjeshtore. Ndeshja e fundit e xhiros zhvillohet në mes të Kamza Basket dhe Tirana Neptun. Kamza, që ndeshjet i zhvillon në Durrës, ka dy fitore dhe katër humbje, ndërsa skuadra kryeqytetase shqiptare ka tri fitore dhe tri humbje, prandaj pritet një përballje interesante të dielën në mbrëmje.

Emma Obrayn, MVP e xhiros së katërt në Ligën Unike

Ndeshje mjaft interesante u zhvilluan në xhiron e katërt të

Ligës Unike në konkurrencën e femrave. Përballjen kryesore e ka fituar Flamurtari, që mundi Bashkimin 60:78, ndërsa lojtarja më e dalluar në parket ishte Emma Obrayn, që realizoi dyshifror të trefishtë me 25 pikë, 11 kërcime dhe 12 asistime, duke u zgjedhur MVP e javës në Ligën Unike. Penza mundi në udhëtim Tiranën 82:96, ndërsa te skuadra pejane u dalluan dy basketbolliste Rael Whitsitt me 32 pikë, 13 kërcime dhe dy asistime, si dhe Mia Long me 29 pikë, tri kërcime dhe tri asistime. Fitore bindëse shënoi Prishtina ndaj Partizanit me shifrat 95:62, ku te skuadra prishtinase më të mirat në parket ishte dyshja e zakonshme Sarah Mgbeike me 32 pikë, 18 kërcime dhe një asistim dhe kapitenia Arbnore Përquku me 29 pikë, 10 kërcime dhe shtatë asistime. Në top pesëshe janë: Emma Obrayn (Flamurtari), Rael Whitsitt (Penza), Sarah Mgbeike (Prishtina), Arbnore Përquku (Prishtina), Mia Long (Penza).

SHKURT

Zyba: Prishtina në pranverë do të kthehet aty ku e ka vendin

Futbollisti Qëndrim Zyba është një ndër talentet më të mëdhenj që aktivizohet në futbollin e Kosovës. Ai ishte i lënduar, por në janar rikthehet nga lëndimi dhe i bashkohet Prishtinës. Zyba në faqen zyrtare të Klubit të FC Prishtinës ka bërë me dije se ecuria e skuadrës nuk ka shkuar ashtu siç e kemi parashikuar. "Prishtina do të kthehet në pranverë shumë shpejt aty ku e ka vendin dhe do ta mbrojë titullin kampion në 100-vjetorin e themelimit të klubit", ka thënë Zyba.

Celina e fiton çmimin e golit më të mirë të muajit në 'League One'

Bersant Celina ka thënë se goli i tij kundër Crewe muajin e kaluar ishte goli më i mirë që ka shënuar në karrierën e tij. Goditja e paharrueshme e kosovarit u emërua si goli i muajit në "League One" për muajin nëntor pasi fitoi 51% të votave në "Twitter". "Sapo e godita, e dija se po hynte", ka thënë Celina. "Ishte një top i mrekullueshëm nga pjesa e pasme dhe sapo pashë hezitimin në mbrojtje, e kuptova se kisha një hap për ta shënuar golin. Kam shënuar disa gola të mirë në karrierën time, por ky ishte më i miri", ka deklaruar Celina.

Trajneri i Realit: Shpresojmë të mos jetë serioz lëndimi i Kosovare Asllanit

Kosovare Asllani është ndalur sërish. Vetëm pak ditë më parë futbollistja shqiptare u kthye nga demontimi dhe në dy ndeshje tregoi se është një prej sulmuesve më të mira në Madrid, duke shënuar tre gola. Por, ajo ka sërish probleme fizike. Asllani u detyrua të lërë para kohe fushën në sfidën që Realit e fitoi 3-0 ndaj Kharkivit. Alberto Toril, trajneri i "Los Blancos", shpreson që të mos ketë diçka serioze. "Do të shohim se çfarë ka Asllani. Shpresojmë që të jetë vetëm një lodhje. Shpresoj që të mos ketë asgjë, por në rast të kundërt, atëherë kemi futbolliste të tjera për të përdorur përpara", ka thënë Toril.

Koljeviqi, MVP i xhiros së 14-t në elitën e basketbollit

Xhironja e 14-t e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll dhuroi ndeshje shumë interesante, sidomos me Prizrenin 16 dhe Sigal Prishtinën dhe Trepçën e Rahovecit, që janë vendosur në minutat e fundit të përballjeve. Basketbollisti i Prizrenit 16, Ivan Koljeviq, ndaj Prishtinës kishte 24 pikë, dy kërcime e tetë asistime, duke u zgjedhur MVP i kësaj xhironje, apo të fundit për stinorin vjeshtor. Ai kishte afër dyshifrorit të trefishtë me 14 pikë, 11 kërcime dhe tetë asistime. Trepça shënoi një fitore shumë të rëndësishme ndaj Rahovecit 91:84 që, gjithashtu, u vendos në fund, ku Drilon Hajrizi shënoi një tri përcaktuese, kurse basketbollisti mitrovicas e mbylli ndeshjen me 20 pikë, katër kërcime e gjashtë asistime. Lojë shumë të mirë zhvilloi edhe Gerald Blackshear me 19 pikë, nëntë kërcime dhe një asistim. Bashkimi shënoi fitore bindëse ndaj Dritës 83:112, ku lojtari më i dalluar në parket ishte Andi Shehu me 22 pikë, 10 kërcime e katër asistime. Top pesësheja: Ivan Koljeviq (Prizreni 16), Drilon Hajrizi (Trepça), Courtney Fells (Prizreni 16), Gerald Blackshear (Trepça), Andi Shehu (Bashkimi).

Orari i ndeshjeve të Kosovës në Ligën e Kombeve

PRISHTINË, 17 DHJETOR - UEFA e ka publikuar orarin e ndeshjeve për edicionin e tretë të Ligës së Kombeve, të cilat do të zhvillohen në qershor dhe shtator të vitit të ardhshëm. Përfaqësuesja e Kosovës do ta nisë këtë edicion në Ligën C, si mysafire me ndeshjen kundër Estonisë ose Qipros më 2

qershor. Këto dy ekipe në muajin mars do ta luajnë ndeshjen e 'play-out'-it dhe fituesi i këtij dueli do t'i vazhdojë garat në Ligën C, derisa humbësi në Ligën D. Muaji qershor do të jetë i ngjeshur për Dardanët, ngaqë do t'i luajnë edhe tri ndeshje të tjera. Më 5 qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" do ta presin

Greqinë, kurse më 9 qershor do të luajnë kundër Irlandës së Veriut. Ndeshjet e këtij muaji Kosova i mbyll si mysafire në duel me Greqinë më 12 qershor. Ndërkaq, në vjeshtë Kosova fillimisht luan si mysafire e Irlandës së Veriut, më 24 shtator, ndërsa tri ditë më vonë në shtëpi e pret Qipron ose Estoninë.



Fituesi i Grupit C2 do të edicionin e ardhshëm të Ligës së promovohet në Ligën B për Kombeve.

Kryetari Idrizi premtion përkrahje për KF Vushtrria

VUSHTRRI, 17 DHJETOR - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, ka prituri në takim kryesinë e Klubit të Futbollit KF Vushtrria. Kryetari Idrizi e ka quajtur klubin e Vushtrrisë si krenarinë e qytetit, derisa

ka premtuar përkrahje. "Sot kam takuar kryesinë e Klubit të Futbollit KF Vushtrria. KF Vushtrria është krenaria e qytetit dhe do të mbetet. Vitin që po hyjmë klubi ynë feston 100-vjetorin e themelimit dhe

jemi në rrugë të mbarë të kthehemi në vendin ku na takon, në Superligë, falë angazhimit të lojtarëve, stafit të trajnerëve dhe përkrahjes së pakursyer të tifozëve 'Forca'. Vëmendje dhe

përkrahje të veçantë do t'i kushtoj sportit. Do të mbështetemi në ligjin 05/L-090 Ligji për sponsorime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, për t'i ndihmuar futbollit, e të gjitha sporteve



në qytetin tonë", ka thënë Idrizi.

Reja: Grup i vështirë, problemi kryesor është largësia

TIRANË, 17 DHJETOR - Shqipëria do të jetë në grup me Islandën, Rusinë dhe Izraelin në Ligën e Kombeve. Trajneri Edy Reja, pasi mësoi emrat e rivalëve, ka thënë se ky grup është shumë i fortë. Trajneri italian ka bërë me dije se objektivi primar është të mos dalin të katërtit. "Doja të evitoja Serbinë, pasi është sigurisht një skuadër shumë e fortë. Edhe Rusia është shumë e fortë dhe doja ta evitoja, por është e qartë që një prej këtyre skuadrave të forta do të na binte në grup. Islandën nuk e njohim mirë, pasi ka ndryshuar shumë dhe ka bërë një ekip me shumë futbollistë të rinj. Është një grup i vështirë, ashtu si të gjithë të tjerët në Ligën B, por ne jemi të bindur që mund të bëjmë mirë. Më vjen keq vetëm sepse ka disa transfera të largëta si Rusia e Islanda, por uroj që të bëhet kalendari dhe të mos i kemi radhazi këto udhëtime. Të shohim, por në tërësi jam i kënaqur. Objektivi primar është të mos dalim të katërtit dhe më pas do të shohim se deri ku do të shkojmë", ka thënë Reja. "Do të nisim në qershor dhe do të



shohim, pasi unë po ndjek skuadrat dhe po mbaj shënime, por nuk e di se kush është më e forta dhe kë duhet të kemi frikë. Duhet t'i vlerësojmë më së pari dhe pastaj të shohim se deri ku mund të shkojmë. Luhen katër ndeshje në harkun e pak ditëve dhe sigurisht që askush nuk mund t'i përballojë të gjitha. Thënë këtë, duhet ta ndryshojmë komplet skuadrën nga ndeshja në ndeshje, ndaj

duhet të studiojmë një strategji për mënyrën si do t'i përballojmë këto sfida, por pasi t'i njohim edhe kundërshtarët. Nuk e di si do të arrijmë në qershor dhe çfarë forme do të kenë futbollistët, sepse mbarojnë kampionatet dhe disa do të jenë të lodhur. Tani dua të luajmë, por deri në qershor do të më bëhej qejfi që të mos luanin shumë, sidomos futbollistët më të rëndësishëm", ka shtuar Reja.

Brooklyni, lider në lindje; Phoenixi, njëjtë si Golden State

BROOKLYN, 17 DHJETOR - Brooklyni vijon të dominojë në renditjen në Konferencën e Lindjes në NBA pas fitores 114-105 ndaj Philadelphia. Kevin Durant ishte lider në fushë për Nets, autor i 34 pikëve, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e Embiid për miqtë. Phoenixi vijon duelin "rotë më rotë" me Golden Staten (të dyja ekipet kanë nga 23 fitore), pas fitores 118-98 ndaj Washingtonit. Fitore kolektive e ekipit të Suns, me 8 lojtarë që realizuan mbi 10 pikë



(Ayton 15 pikë e 10 rebounde). Fiton edhe skuadra e Indianas, që mundi me rezultat 122-113 Detroitin, në një ndeshje ku diferencën e bëri LaVert, autor i

31 pikëve, më i miri në parket. Ndërsa skuadra e New York, falë 24 pikëve të Quickley dhe 23 të Fournier, mundi me rezultat 116-103 Houstonin.

REZULTATET

| | |
|-------------------------|---------|
| Indiana - Detroit | 122-113 |
| Brooklyn - Philadelphia | 114-105 |
| Houston - New York | 103-116 |
| Phoenix - Washington | 118-98 |

Kloppi kundër shtyrjes së ndeshjeve në Premierë Ligë

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, nuk dëshiron një pauzë totale në Ligën Premierë, pas zërave të shumtë për shtyrjen e ndeshjeve. Klubet në Angli po përballen me

shpërthime të mëdha të Covid-19 për shkak të një varianti më të transmetueshëm të virusit siç është "Omicron". Pesë nga dhjetë ndeshjet e planifikuara për t'u

zhvilluar në fundjavë janë shtyrë, ndërsa vetë Liverpooli ishte skuadër e prekur. "Reds" kishte mungesë tre lojtarët si rezultat i testeve pozitive kur mposhten Newcastle

Unitedin me rezultat 3-1 të enjten, por kjo nuk e pengon Kloppin. "Ndalimi i ligës ndoshta nuk është gjëja e duhur, por me orarin duhet të jemi më fleksibël", ka thënë fillimisht Klopp për "BBC".

"Deri më tani futbollit e mbajti atë shumë jashtë me regjimet e testimit, gjërat e mëdha disiplinore për djemtë shkuan shumë mirë, por këtë herë është vërtet e vështirë", ka deklaruar trajneri gjerman.

SHKURT

Erikseni ndërpret bashkëpunimin me Interin

Christian Eriksen ka ndërprerë bashkëpunimin në mënyrë konsensuale me skuadrën e Interit, pasi shteti italian nuk e lejon që ai të luajë në këtë gjendje dhe me një debrifilator në zemrën e tij. Më 12 qershor ai pësoi një atak kardiak në minutat e fundit të pjesës së parë në ndeshjen ku Danimarka po zhvillonte ndeshjen ndaj Finlandës në "Euro 2020". E gjithë bota e futbollit dhe jo vetëm u shokua dhe u sensibilizua me danezin i cili, pas ndërhyrjes së shpejtë të mjekëve dhe shtrimit menjëherë në spital, i mundësuan që ta rikthenin sërish në jetë tashmë ish-yllin e Interit. Erikseni do të jetë në ndeshjen e parë të vitit 2022 në "Giuseppe Meazza" për t'i përshëndetur për herë të fundit si lojtar zikaltër tifozët që gjithmonë i qëndruan pranë.

Verstappeni: Hamiltoni s'ka nevojë të dorëzohet, le ta ndjekë titullin e tetë

Skenat e xhirove të fundit në garën e fundit të vitit 2021 kanë bërë që shumë njerëz të dëshpërohen nga Formula 1. Një nga ta është edhe shtatë herë kampioni botëror, Lewis Hamilton. Drejtori sportiv i Mercedesit, Toto Wolff, ka thënë se nuk mund të garantojë që Hamiltonit do të garojë edhe në vitin tjetër në Formula. Këto fjalë kanë shqetësuar adhuruesit e F1. Kohë për të komentuar këtë situatë ka gjetur edhe Max Emilian Verstappen, i cili ka ftuar britanikun të garojë edhe në vitin tjetër. "Mund të kuptoj se në ditët e para pas një gare të atillë nuk mund të jesh i lumtur. Por, duhet, po ashtu, të kuptosh se kjo është garë dhe gjëra të tilla ndodhin. Ai duhet të shohë prapa në ato se çfarë ka arritur. Kjo duhet t'i jap qetësi dhe duhet ta shtyjë të vazhdojë, sepse ai ende po e ndjek titullin e tetë dhe sigurisht se mund ta bëjë vitin tjetër, kështu që nuk shoh arsye të dorëzohet", ka thënë Verstappen. Piloti holandez është shpallur kampion botëror në F1 2021 për herë të parë në karrierën e tij dhe është njëkohsisht holandezi i parë që arrin një gjë të tillë.

Khabib: Lewandowski dhe Benzema para Messit e merituan 'Topin e Artë'

Ylli i MMA, Khabib Nurmagomedov, është bërë personaliteti i fundit që thotë se Lionel Messi nuk e meritonte ta fitonte çmimin "Topi i Artë" për vitin 2021.

"Unë do t'ia jepja Lewandowskit ose Benzemas. Njërit prej tyre. Lewandowskit, mendoj. Në tre vjetët e fundit ai është futbollisti më i mirë. Ne mund t'i shohim rezultatet e tij. Çfarë bën ai. Ai ka fituar Ligën e Kampionëve. Ai ka shënuar më shumë se 120 gola në dy vjetët e fundit. Për kombëtaren dhe klubin, është një rezultat i mrekullueshëm", ka deklaruar luftëtari i MMA-s.

Reali interesohet për Comanin

Klubet e mëdha evropiane janë duke u interesuar për yllin e Bayern Munchenit, Kingsley Coman. "Fichajes" raporton se skuadra e fundit që është duke e monitoruar situatën e futbollistit francez është Real Madridi. Anëtori francez ka një kontratë të vlefshme deri në vitin 2023 me Bayernin, por bisedimet për rinovimin e marrëveshjes kanë ngecur. Real Madridi, gjithashtu, për afatin e verës planifikon edhe transferimin e sulmuesit Kylian Mbappe.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Maico East Depo” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811350719, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Maico East Depo” D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811350719 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Maico East Depo” L.L.C. in Pristina, has come to the decision to quit its business: nr. 811350719 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Edis Gashi shpall te pavlefshme dëftesën e kl XI dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Shake Hadergjonaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Eren Halabak shpall te pavlefshme dëftesën e kl VI - IX shfm " Avdyl Frasheri " Prizren.

▶ Gresa Selmani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Bajram Curi" Krush e Madhe.

▶ Ndiriçim Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm " Avdyl Frasheri " Prizren.

▶ Egzon Rashkaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

